

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të pandehurit **R. R.**, nga K., me vendbanim në Gj., për shkak të veprës penale “**rrezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme**” nga neni 380 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.nr.1609/2016, e datës 05.09.2016, më datën 03.10.2016, mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit :

R. R., i lindur më ... nga fshati K., Komuna e K., me vendbanim në Gj., shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës.

Është fajtor

Sepse më datën..., rreth orës ... minuta, në Gj., në rrugën “...” i pandehuri duke vu pengesa në rrugën publike ka rrezikuar trafikun publik në atë mënyrë që e merr një guri të madh dhe e vendos mbi një kapak të shaktës, ashtu që deri sa i dëmtuari **B. A.**, ka qenë duke drejtuar automjetin e tij “...” ngjyrë e ... me tabela ... hasë në guri dhe e dëmton mbrojtësin e përparme, ftohësin e motorit, ftohësin e motorit dhe të klimës me m'çrast tani të dëmtuarit **B.**, i shkakton dëm në vlerë të pa përcaktuar.

- me çka ka kryer veprën penale **rrezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme**, nga neni 380 paragrafi 1 të KPRK.

Andaj, në bazë të dispozitës së lartëcekur ligjore dhe neneve 4,17, 21 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe të neneve 493 dhe 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës të pandehurit i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit **R. R.**, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej **150 € (njëqindpesëdhjetë Euro)**, të cilin dënim i pandehuri do t'a paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

I dëmtuari **B. A.**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet i pandehuri që t'i paguajë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 15 Euro ndërsa shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

*Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit **R. R., nga fshati K.,** me vendbanim në Gj., për shkak të veprës penale “rrezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme” nga neni 380 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjën e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t’i shqiptohet dënimi me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.*

*Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për dhënjën e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit **R. R.,** dhe të pandehurit i shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.*

*Në bazë të deklaratës të të pandehurit, deklaratës të së dëmtuarit **B. A.,** si dhe shkresave tjera të lëndës, gjyqtari konstatoi se i pandehuri **R. R.** ka kryer veprën penale “rrezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme” nga neni 380 paragrafi 1 i KPRK në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.*

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënimi me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimin me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimin, nga neni 41 i KPRK..

Vendimi për kërkesën pasurore juridike dhe shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 451 dhe nenin 463 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPPRK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i përgjithshëm

Më 03.10.2016

**Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi**

**Gjyqtari,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. I pandehuri njoftohet se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtimi nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.